



Prishtinë, 24.06.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1534\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2303\_04\_22** i dt.26.04.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës 24.05.2022.

në seancën e mbajtur më datë 24.06.2022 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A.B nga Komuna e Prishtinës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2303\_04\_22 i dt.26.04.2022.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 26.04.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2303\_04\_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjen e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 08.06.2020 lidhur me kontestimin e faturës nr. 0317221707DPR- 90119906 datë 23.03.2017 me njehsorin elektrik nr. 3772225.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, pala A.B , brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njejtë është i padrejtë;
- Pretendon se që nga fillimi i vitit 2011 shifra DPR 90010400 ka qenë pasive dhe 32,203 kWh e cekur nga KEDS-i janë shpenzuar në periudhën 2003-2010;
- Pala kërkon nga Bordi që të shqyrtoj ankesën në kohë dhe të merr vendim të drejtë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi nr. 0317221707DPR - 90119906 datë 23.03.2017 me njehsorin elektrik nr. 3772225 nuk është i saktë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Procesverbali i inspektimit nr. 1396310 datë 21.02.2017; Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e



njehsorit elektrik nr. 0657954 datë 22.02.2017; Faturat nr. 0317221707DPR- 90119906 datë 23.03.2017; Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 29.11.2019; Përgjigja e KESCO-s datë 08.06.2020; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 02.11.2021; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2303\_04\_22 i dt.26.04.2022, gjeti se punëtorët e KEDS-it që nga fillimi i inspektimit kanë vërejtur se njehsori nuk është në rregull dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit të vjetër me atë të ri, pastaj bazuar në ankesën e konsumatorit kanë bërë korrigjimin e kWh të faturuar në faturën nr. 0317221707DPR – 90119906 në vlerë prej **-665.77 euro** duke bërë shpërndarjen e kWh për periudhën një vjecare 04/2016 deri në periudhën 03/2017. Kështu KESCO ka vepruar konform Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, andaj nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Në shqyrtim e sipër të rastit, ZRrE ka vërejtur se, fillimisht me datë 21.02.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 3772225 ku TL=84995 kWh si dhe kanë evidentuar që: me rastin e kontrolles është konstatuar se njehsori është i pa vulosur, nuk është i regjistruar në CCP si dhe që pala obligohet të bëjë kërkesë në KEDS për lidhje të re, se është hapur kapaku i njehsorit për kontroll dhe kemi vërejtur se klema e fazës L-1 është e djegur, njehsori duhet të ndërrohet dhe duhet të vendoset njehsori i ri nga KEDS. Po ashtu ekipi i KEDS-it ka evidentuar që ekipi përgjegjës për pranimin e instalimeve elektrike të bëjë pranimin e njehsorit si dhe të faturohen kWh e shpenzuar si dhe të shikohet nëse ka shënime për këtë njehsorë në arkiva të KEDS. Me datë 22.02.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 3772225 me gjendje TL=85000 kWh dhe kanë vendosur për matje njehsorin e ri nr. 67256842 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që të konsumatori bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik bazuar në procesverbalin nr. 1396310, njehsori i vjetër dërgohet në verifikim. Me datë 23.03.2017 Departamenti i faturimit në KESCO e ka ngarkuar konsumatorin me faturën nr. 0317221707DFP- 90119906 me **32,203 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **4,010.05€**. Me datë 29.11.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturën nr. 0317221707DPR- 90119906 datë 23.03.2017 për shkak të faturimit jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 3772225. Me datë 08.06.2020 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij duke bërë korrigjimin në vlerë **-665.77 €**, përkatësisht duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuara në faturën nr. 0317221707DFP- 90119906 datë 23.03.2017 për periudhën njëvjeçar 04/2016 deri në periudhën 03/2017 bazuar në procesverbalin për pranim të instalimit elektrik nr. 0657954 datë 22.02.2017. Me datë 02.11.2021 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO lidhur me kontestimin e faturës nr. 0317221707DPR- 90119906 datë 23.03.2017 me njehsorin elektrik nr.3772225. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 26.04.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2303\_04\_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit.

Bordi, pas shqyrtimit të rastit dhe analizimit të të gjitha provave veç e veç, konstaton se sipas transaksioneve të shifrës DPR-90010400 e cila ka qenë në të njëjtën adresë por në emër të konsumatorit “Qebaptore” Minire Maliqi ky njehsor ka qenë duke e furnizuar këtë shifër deri në periudhën janar 2003 kur edhe e njëjta është arkivuar dhe se gjendja e fundit e lexuar e shpenzimeve ka qenë TL=52797 kWh. ZRrE ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se:” *Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese*”.



Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit A.B dhe
- Arkivit të ZRRE-së.